



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde– Ministry of Justice

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 09/2019 PËR KUSHTET E ZYRËS NOTERIALE, HAPËSIRAT
DHE PAJISJET¹**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MOJ-NO. 09/ 2019 ON THE TERMS OF NOTARY OFFICE,
FACILITIES AND EQUIPMENT²**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MP-BR. 09/2019 USLOVI NOTARIJSKOG UREDA, OBJEKATA I
OPREME³**

¹ Udhëzim Administrativ MD-Nr. 09/2019 për Kushtet e Zyrës Noteriale, Hapësirat dhe Pajisjet, i nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë, më datë 27.11.2019.

² Administrative Instruction MOJ-No. 09/ 2019 On The Terms Of Notary Office, Facilities And Equipment, signed by Minister of Justice, date 27.11.2019.

³ Administrativno Uputstvo MP-Br. 09/2019 Uslovi Notarijskog Ureda, Objekata I Opreme, je potpisano od strane Ministar Pravde, datum 27.11.2019.

<p>Ministri i Ministrisë së Drejtësisë,</p> <p>Në mbështetje të nenit 21, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06 /L-010 (GZ nr. 23, 26 Dhjetor 2018) nenit 8 nën paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerrë:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 09/2019 PËR KUSHTET E ZYRËS NOTERIALE, HAPËSIRAT DHE PAJISJET</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen kushtet, hapësirat dhe pajisjet e nevojshme të zyrës noteriale.</p> <p>Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të obligueshme për të gjithë noterët në Republikën e Kosovës.</p>	<p>Minister of the Ministry of Justice,</p> <p>Pursuant to Article 21, paragraph 4 of Law no. 06 / L-010 (OG no. 23, 26 December 2018) under Article 8 paragraph 1.4 of Regulation No. 02/2011 on areas of administrative responsibility of the Prime Minister and Ministries, as well as Article 38, paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government no. 09/2011 (Official Gazette No. 15, 12.09.2011),</p> <p>issued:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MOJ-NO. 09/ 2019 ON THE TERMS OF NOTARY OFFICE, FACILITIES AND EQUIPMENT</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>This Administrative Instruction governs the conditions, necessary facilities and equipments to the notary office.</p> <p>Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this administrative instruction are mandatory for all notaries in the Republic of Kosovo.</p>	<p>Ministar Ministarstva pravde,</p> <p>Na osnovu člana 21, stav 4 Zakona br. 06 / L-010 (SL br. 23, 26. decembar 2018. godine) prema članu 8 stav 1.4 Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti premijera i ministarstava, kao i člana 38, stav 6 Pravilnika o postupku Vlade br. 09/2011 (Službeni glasnik br. 15, 12.09.2011),</p> <p>izdaje ovo:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MP-BR. 09/2019 USLOVI NOTARIJSKOG UREDA, OBJEKATA I OPREME</p> <p>Član 1 Svrha</p> <p>Ovo Administrativno Uputstvo uređuje uslove, neophodne objekte i opremu za notarsku kancelariju.</p> <p>Član 2. Delokrug</p> <p>Određbe ovog administrativnog uputstva su obavezne za sve notare u Republici Kosovo.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 3 Selia e zyrës së Noterit</p> <p>1. Noteri duhet të ketë një zyrë, vendndodhja e së cilës duhet të jetë brenda territorit të përcaktuar në vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e Noterit.</p> <p>2. Zyra noteriale mund të hapet në një ndërtesë private apo shtetërore e cila i plotëson kriteret e parapara me këtë Udhëzim Administrativ.</p> <p>3. Objekti i zyrës noteriale mund të jetë në pronësi të noterit ose e marrë me qira apo në çfarëdo forme tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>4. Për adresën e saktë të zyrës noteriale duhet të njoftohet me shkrim Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Noterëve, brenda 15 ditësh nga dita e hapjes së zyrës noteriale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Notary Seat</p> <p>1. The notary must have an office whose location must be within the territory specified in the decision of the Ministry of Justice on the appointment of the Notary.</p> <p>2. Notary Office can be opened in a private or public building which meets the criteria set forth in this Administrative Instruction.</p> <p>3. The premise of the notary office can be owned by a notary or rented or in any other manner in accordance with applicable legislation.</p> <p>4. Within 15 days of opening the notary office, the notary shall notify in writing the Ministry of Justice and the Chamber of Notaries, about the exact address of the notary office.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Sedište kancelarije notara</p> <p>1. Notar mora imati kancelariju čija lokacija mora biti na teritoriji određenoj odlukom Ministarstva pravde o imenovanju javnog notara.</p> <p>2. Kancelarija notara se može otvoriti u privatnoj ili javnoj zgradi koja ispunjava kriterijume navedene u ovom Administrativnom uputstvu.</p> <p>3. Prostor notarske kancelarije može biti u vlasništvu notara ili iznajmljen ili na bilo koji drugi način u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. U roku od 15 dana od otvaranja notarske kancelarije, notar će pismeno obavestiti Ministarstvo pravde i Komoru notara o tačnoj adresi notarske kancelarije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Hapësirat e zyrës Noteriale</p> <p>1. Zyrat Noteriale duhet të jenë me sipërfaqe të mjaftueshme për të lejuar ushtrimin normal të veprimtarisë noteriale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Spaces of notary office</p> <p>1. Notarial offices must have sufficient space to allow the normal exercise of notary affairs.</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Prostori notarske kancelarije</p> <p>1. Notarske kancelarije moraju imati dovoljno prostora da omoguće normalno beležništvo.</p>

<p>2. Zyra noteriale duhet ta ketë hapësirën e përgjithshme së paku 50 m2, dhe duhet të përmbajë së paku dhomën e pritjes së palëve, dhomën e punës dhe arkivin.</p> <p>3. Zyra noterit duhet të ketë hyrje të veçantë.</p> <p>4. Në ndërtesën që nuk ka ashensor, zyra noteriale duhet të vendoset më së shumti deri në katin e dytë.</p> <p>5. Rregullimi i brendshëm i lokaleve duhet të garantoj besueshmërinë noteriale dhe privatësinë e palëve.</p>	<p>2. The notary office shall have overall space of at least 50 m2, and must at least consist of the waiting room of parties, the working room and archive.</p> <p>3. Notary office must have separate entrance.</p> <p>4. In a building that has no elevator, notary office should be set up mostly on the second floor.</p> <p>5. Internal setting of the premises must guarantee notary reliability and privacy of the parties.</p>	<p>2. Notarska kancelarija treba da ima ukupan prostor od najmanje 50 m2 i najmanje mora da sadrži čekaonicu stranaka, radnu sobu i arhivu.</p> <p>3. Notarska kancelarija mora imati odvojene ulaze.</p> <p>4. U zgradi koja nema lift, kancelarija notara treba da bude postavljena najviše na drugom spratu.</p> <p>5. Unutrašnja regulativa u prostorijama mora da garantuje notarsku pouzdanost i privatnost stranaka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Ruajtja e Dokumenteve</p> <p>1. Dosjet, dokumentet dhe shtojcat e tyre duhet të ruhen ashtu që të sigurohen nga vjedhja, zjarri apo dëmtimi nga ujërat.</p> <p>2. Sigurimi i zyrës noteriale duhet të jetë në pajtim me dispozitat të cilat rregullojnë mbrojtjen kundër zjarrit në organet e administratës shtetërore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Document Storage</p> <p>1. The files, documents and their annexes must be stored so as to secure them against theft, fire or water damage.</p> <p>2. The security of notary office should be in accordance with the provisions regulating fire protection in the state administration.</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Skladištenje dokumenata</p> <p>1. Spisi, dokumenti i njihovi prilozi moraju se čuvati tako da se osiguraju od krađe, požara ili oštećenja vodom.</p> <p>2. Sigurnost notarske kancelarije treba da bude u skladu sa odredbama koje regulišu zaštitu od požara u državnoj upravi.</p>

<p align="center">Neni 6 Pajisjet e zyrës Noteriale</p>	<p align="center">Article 6 Notary Office Equipments</p>	<p align="center">Član 6 Oprema u notarskoj kancelariji</p>
<p>1. Zyra noteriale përveç pajisjeve tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e punës duhet të ketë së paku pajisjet në vijim:</p> <p>1.1. Kompjuter me pajisje dhe me lidhje interneti;</p> <p>1.2. printer kompjuter;</p> <p>1.3. pajisje mekanike për shkrim (makine shkrimi);</p> <p>1.4. makinë fotokopjuese;</p> <p>1.5. telefon dhe faks;</p> <p>1.6. kasaforta e sigurisë;</p> <p>1.7. rafte (dollape) zjarrduruese;</p> <p>1.8. pajisje zjarrfikëse.</p>	<p>1. Notary Office in addition to other equipments necessary for the conduct of business should have at least the following devices:</p> <p>1.1. Computer with equipments and Internet connection;</p> <p>1.2. computer printers;</p> <p>1.3. mechanical writing device (typewriter);</p> <p>1.4. photocopying machine;</p> <p>1.5. telephone and fax;</p> <p>1.6. safety box;</p> <p>1.7. fireproof shelves (cabinets);</p> <p>1.8. firefighting equipment.</p>	<p>1. Notarska služba, pored druge opreme neophodne za obavljanje poslova, treba da ima najmanje sledeće uređaje:</p> <p>1.1. Računarska oprema i internet konekcija;</p> <p>1.2. računarski štampači;</p> <p>1.3. mehanički uređaj za pisanje (pisaći stroj);</p> <p>1.4. fotokopirna mašina;</p> <p>1.5. telefon i faks;</p> <p>1.6. sef;</p> <p>1.7. vatrootporne police (ormari);</p> <p>1.8. protivpožarna oprema.</p>
<p align="center">Neni 7 Shenjat e identifikimit të zyrës noteriale</p>	<p align="center">Article 7 Identification mark of the notary office</p>	<p align="center">Član 7 Identifikacija označava notarsku službu</p>
<p>1. Noteri është i detyruar që ta vendosë një tabelë metalike me dimensione 30x30 cm në</p>	<p>1. The notary is obliged to place a metal table with 30x30 cm dimensions in the visible</p>	<p>1. Notar je dužan da na vidljivom mestu objekta, ili na ulazu gde se nalazi notarska</p>

<p>vendin e dukshëm të objektit, përkatësisht në hyrjen ku gjendet zyra e noterisë, në të cilën duhet të figurojë stema e Republikës së Kosovës dhe shënimi « NOTER ».</p> <p>2. Noteri po ashtu vendosë një tabelë në të cilën shënohet shënimi « NOTER », emri, mbiemri dhe grada shkencore e noterit. Përmasat maksimale të kësaj table janë 60x80cm. Kjo tabelë ka një dukje të thjeshtë dhe nuk përmban asnjë mjet për ta bërë më të dukshëm.</p> <p>3. Noteri mund ta vë dhe tabelën shtesë me shenjën “NOTER”, me tabelën udhëzuese (shigjetë), në afërsi të zyrës së tij, në formë dhe madhësi standarde.</p> <p>4. Tabelat duhet të jenë të shënuara në pajtim me Ligjin mbi gjuhët zyrtare në Kosovë, me shkronja të mëdha me ngjyrë ari në sfond të errët.</p>	<p>location of the facility, more specifically at the entrance where the notary office is located, in which there should be the emblem of the Republic of Kosovo and the note "NOTARY".</p> <p>2. The notary should also put up a table on which is written the note "NOTARY" name, surname and academic degrees of notary. The maximum size of this table is 60x80cm. This table has a simple appearance and contains no means to make it more visible.</p> <p>3. The Notary may put an additional table marked "NOTARY", with guiding table (arrow) in the vicinity of his office, in standard form and size.</p> <p>4. Tables should be marked in accordance with the Law on official languages in Kosovo, in capital letters with gold color on the dark background.</p>	<p>kancelarija, postavi metalnu tabelu sa dimenzijama 30x30 cm, na kome bi trebalo da bude amblem Republike Kosova i beleška " NOTAR".</p> <p>2. Notar treba da postavi i tabelu na kojoj se piše napomena "NOTAR" ime, prezime i stepen notara. Maksimalna veličina ove table je 60x80cm. Ova tabela ima jednostavan izgled i ne sadrži sredstva koja bi je učinila vidljivijom.</p> <p>3. Notar može postaviti dodatnu tablicu sa oznakom "NOTAR", sa tabelom vođenja (strelica) u blizini svoje kancelarije, u standardnom obliku i veličini.</p> <p>4. Tabele treba označiti u skladu sa Zakonom o službenim jezicima na Kosovu, velikim slovima sa zlatnom bojom na tamnoj pozadini.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Verifikimi i lokaleve dhe pajisjeve të zyrave noteriale</p> <p>1. Për verifikimin e gjendjes së lokaleve dhe pajisjeve të zyrave noteriale në pajtueshmëri me dispozitat e këtij udhëzimi,</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Verification of premises and equipments of notary offices</p> <p>1. To verify the state of the notary office premises and equipments in accordance with the provisions of this Instruction, the Minister</p>	<p style="text-align: center;">Član 8. Verifikacija prostorija i opreme notara</p> <p>1. Za proveru statusa prostorija i opreme notara u skladu sa odredbama ove direktive, ministar pravde imenuje komisiju za proveru</p>

<p>Ministri i Ministrisë së Drejtësisë emëron Komisionin për verifikimin e lokaleve dhe pajisjeve të zyrave noteriale.</p> <p>2. Komisioni përbëhet nga tre anëtar që duhet të jenë të diplomuar në fushën e Drejtësisë, ndërtimtarisë, arkitekturës apo ekonomisë.</p> <p>3. Komisioni është i obliguar që të vërtetoj gjendjen faktike dhe juridike të zyrës noteriale në pajtim me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.</p> <p>4. Komisioni duhet të përgatisë procesverbalin për secilën zyrë noteriale dhe të paraqesë rekomandimin për pajtueshmërinë e lokaleve dhe pajisjeve të zyrës noteriale me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.</p> <p>5. Nëse rekomandimi i Komisioni është negativ, kandidati për noter ka të drejtë që në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të rekomandimit të Komisionit, të kërkoj rivefikimin e lokalit dhe pajisjeve të zyrës noteriale.</p> <p>6. Lokali nuk mund të përdoret për zyrë noteriale, nëse Komisioni pas verifikimit të përsëritur rekomandon që lokali dhe pajisjet nuk janë në pajtim me kriteret e përcaktuara</p>	<p>of the Ministry of Justice appoints the Commission for the verification of the notary office premises and equipments.</p> <p>2. The Commission consists of three members who must be graduates in the field of Justice, civil engineering, architecture or economics.</p> <p>3. The Commission is obliged to verify the factual and legal situation of the notary office in accordance with the criteria set out in this administrative instruction.</p> <p>4. The Commission shall prepare minutes for each notary office and submit a recommendation on the compatibility of the notary office premises and equipment with the criteria set out in this administrative instruction.</p> <p>5. If the recommendation of the Commission is negative, the candidate for notary is within a period of eight (8) days of receipt of the Commission's recommendation, entitled to request a new verification of premises and equipments of notary office.</p> <p>6. The premises cannot be used for notary's office, if the Commission after a repeated verification recommends that the facility and equipments are not in accordance with the</p>	<p>prostorija i opreme notara.</p> <p>2. Komisija se sastoji od tri člana koji moraju biti diplomirani pravnici u oblasti pravosuđa, građevinarstva, arhitekture ili ekonomije.</p> <p>3. Komisija je obavezna da potvrdi činjenično i pravno stanje notarske kancelarije u skladu sa kriterijumima utvrđenim u ovom Administrativnom uputstvu.</p> <p>4. Komisija priprema zapisnik za svaku notarsku kancelariju i dostavlja preporuku o kompatibilnosti prostorija i opreme notarske kancelarije sa kriterijumima utvrđenim ovim administrativnim uputstvom.</p> <p>5. Ako je preporuka Komisije negativna, kandidat za notara ima pravo na period od osam (8) dana od dana prijema preporuke Komisije, da traži novu provjeru prostorija i opreme notarske kancelarije.</p> <p>6. Prostorije se ne mogu koristiti za kancelariju notara, nakon provere ako je Komisija stalno preporučivala da objekat i oprema nisu u skladu sa kriterijumima</p>
---	--	--

<p>në këtë udhëzim administrativ.</p> <p>7. Nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara, Ministria e dorëzon procesverbalin tek Oda e Noterëve (në tekstin e mëtejme: Oda).</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Shfrytëzimi i hapësirës së përbashkët</p> <p>1. Noteri mund të ndajë shfrytëzimin e hapësirave të zyrës noteriale me noter tjetër me pëlqimin e Këshillit Drejtues të Odës së Noterëve.</p> <p>2. Noteri nuk mund të ndajë hapësirat e zyrës noteriale me përfaqësuesit e profesioneve të tjera.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Numri dhe lokacioni i Zyrave Noteriale</p> <p>1. Numri dhe lokacioni i zyrave noteriale përcaktohet sipas kriterëve të parapara në nenin 8 të Ligjit për Noterinë.</p> <p>2. Zyrat noteriale në Republikën e Kosovës parashihen me vendim të veçantë për territorin e një komune.</p>	<p>criteria set out in this administrative instruction.</p> <p>7. If all the provided conditions are fulfilled, the Ministry shall submit the report to the Chamber of Notaries (hereinafter: the Chamber).</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Using a common space</p> <p>1. Notary may share the use of the notary office space with another notary with the consent of the Governing Council of the Chamber of notaries.</p> <p>2. Notary may not share the notary office premises with representatives of other professions.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 The number and location of Notary Offices</p> <p>1. The number and location of notarial offices are set according to the criteria set forth in Article 8 of the Law on Notary.</p> <p>2. Notary offices in the Republic of Kosovo are established with a special decision for the territory of a municipality.</p>	<p>navedenim u ovom administrativnom uputstvu.</p> <p>7. Ako su ispunjeni uslovi, Ministarstvo dostavlja izvještaj Komori Notara (u daljem tekstu: Komora).</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Korišćenje zajedničkog prostora</p> <p>1. Notar može da koristi prostorije notarskog ureda sa drugim notarom uz saglasnost Upravnog Odbora Notarske komore.</p> <p>2. Javni notar ne sme da deli prostorije notarske kancelarije sa predstavnicima drugih profesija.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Broj i lokacija notarskih ureda</p> <p>1. Broj i lokacija notarskih ureda određeni su kriterijumima utvrđenim u članu 8 Zakona o notarima.</p> <p>2. Kancelarije notara u Republici Kosovo dobijaju posebnu odluku na teritoriji opštine.</p>
--	---	---

<p>3. Ministri i Ministrisë së Drejtësisë me vendim të veçantë mund të autorizojë noterin e caktuar që të ofrojë shërbime noteriale në komunën tjetër pa e ndërruar selinë e zyrës noteriale.</p> <p>4. Noteri, komuna, koha dhe orari i ofrimit të shërbimeve noteriale dhe detajet tjera të autorizimit sipas paragrafit 3 të këtij neni do të përcaktohen me vendim.</p> <p>5. Ministri e Drejtësisë në konsultim me Odën e Noterëve bënë rishikimin e zyrave noteriale nëpër komuna dhe vendos për zvogëlimin apo rritjen e numrit të zyrave noteriale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Dispozita Shfuqizuese</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2011, për numrin dhe lokacionin e zyrave noteriale si dhe lokalet dhe pajisjet e nevojshme të noterit.</p>	<p>3. The Minister of the Ministry of Justice may, by special decision, authorize the designated notary to provide notarial services in another municipality without changing the seat of the notary office.</p> <p>4. The notary, the municipality, the time and schedule of the notarial service and other details of the authorization referred to in paragraph 3 of this Article shall be determined by decision.</p> <p>5. The Minister of Justice in consultation with the Chamber of Notaries reviews the notary offices in municipalities and decides to reduce or increase the number of notary offices.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Repealing provisions</p> <p>With the entry into force of this Administrative Instruction, the Administrative Instruction No. 08/2011, on the number and location of notary offices and necessary notary premises and equipment, shall be repealed.</p>	<p>3. Ministar pravde sa posebnom odlukom može da ovlasti imenovanog notara da pruži notarskih usluga u drugoj opštini bez promene sedišta notarske kancelarije.</p> <p>4. Notar, opština, vreme i raspored pružanja notarskih usluga i drugi detalji ovlašćenja prema stavu 3. ovog člana utvrđuju se odlukom.</p> <p>5. Ministar pravde u konsultaciji sa Notarskom komorom pregleda notarske kancelarije u opštinama i odlučuje da smanji ili poveća broj notarskih kancelarija</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Odredbe o ukidanju</p> <p>Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva, Administrativno uputstvo br. 08/2011, o broju i lokaciji notarske kancelarije i neophodne prostorije i opremu notara, se ukida.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 12 Hyrja në fuqi</p>	<p align="center">Article 12 Entry into force</p>	<p align="center">Član 12 Stupanje u snagu</p>
<p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit.</p> <p align="right"> Abelard Tahiri <hr/> Ministër i Drejtësisë 27/11/2019 </p>	<p>This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after its signing by the Minister.</p> <p align="right"> Abelard Tahiri <hr/> Minister of Justice 27/11/2019 </p>	<p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od strane Ministra.</p> <p align="right"> Abelard Tahiri <hr/> Ministar pravde 27/11/2019 </p>